



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 6, DATË 07 / 05 / 2024

PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR
PROJEKTIN E INVESTIMIT “RESORT NË GJIRIN E LLAMANIT” ME
SUBJEKTE APLIKUESE CAPITAL B SHPK NUIS L41924002T DHE
BEGA-07 SHPK K73312401J

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit parashikon ndërtimin e resortit turistik, ku do të ketë një hotel me 5 Yje si dhe njësi akomoduese vila, së bashku me ambiente shërbimi si restorante, SPA, zonë eventesh, pishinë dhe akuapark në një sipërfaqe prej afërsisht 101,288 m², Bashkia Himarë.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 63,246,500 Euro (gjashtëdhjetë e tre milion e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 144 punonjës.
- Projekti do të realizohet në një sipërfaqe totale prej 101,288 m², në ZK 1952, Gjiri i Llamanit, Bashkia Himarë, një pjesë e së cilës pretendohet të jetë në pronësi shtetërore.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Resort në Gjirin e Llamanit”, me subjekte investuese Capital B shpk NUIS L41924002T dhe Bega-07 shpk K73312401J, Bashkia Himarë në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Zona e projektit nuk ka një regjistrim fillestar në kadastër, mosregjistrim i cili pengon marrjen e veprimeve të mëtejshme ligjore nga ana e institucioneve.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

ERVIN METE

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
LAURA PLAKU (SARO)**